



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

---

A.nr.10/2024

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Arsim Hamzaj - kryesues, Kujtim Pasuli e Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Qazim Rahmanit nga koalicioni politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës, PDAK dhe Lëvizja për Bashkëveprim (LpB) - me seli në Ferizaj, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos emërimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.09.2024, mori këtë,

### V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar** ankesa Anr.10/2024 e datës 19.09.2024, e paraqitur nga Qazim Rahmani nga koalicioni politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës, PDAK dhe Lëvizja për Bashkëveprim LpB, me seli në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të obligoj KQZ-në, për emërimin e kandidatit të tyre në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës.

### A r s y e t i m

Me datë 19.09.2024, PZAP-i, ka pranuar një ankesë të paraqitur nga Qazim Rahmani nga koalicioni politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës, PDAK dhe Lëvizja për Bashkëveprim LpB, me seli në Ferizaj, të parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën pretendon se bazuar në vendimin e KQZ-së, për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve, koalicioni PDAK-LpB janë të pa kënaqur sepse asnjë anëtar nga ne nuk është emëruar në asnjë komunë në KKZ. Me tutje parashtruesi i ankesës thekson se kemi kërkuar të emërohen në disa komuna ku komuniteti ashkali është komuniteti me i madh si në komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Ferizajt dhe Lipjanit, dhe bazuar në rezultatin e fundit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, subjekti politik PDAK dhe LpB kanë trup votues me të lartë se çdo komunitet dhe subjekt politik minoritar.

Po ashtu parashtuesi i ankesës thekson se subjekti politik PDAK, pas shpalljes se zgjedhjeve parlamentare të Republikës së Kosovës ka nominuar Shaban Shemën për anëtar të KKZ-së nga subjekti i tyre, ku sipas parashtuesit theksohet se nominimin e kanë dërguar me kohë në KQZ përmes postes elektronike, mirëpo konform afateve ligjore për emërimin e anëtareve të KKZ-së nga ana e KQZ-së, subjekti politik PDAK nuk ka pranuar asnjë informatë për emërimin e kandidatit nga radhët e subjektit politik PDAK.

Me tutje në ankese theksohet se kandidati i nominuar për anëtarë të KKZ-së, në Prishtinë ka të drejtë vote në komunën përkatëse, me përvojë administrative zgjedhore dhe ka njohuri të mjaftueshme që i mundëson të kryej detyrën e vet në mënyrë efektive, dhe njëherit të përfaqësojë edhe komunitetin ashkalinjë në Prishtinë, dhe se PDAK dhe komuniteti ashkalinjë në komunën e Prishtinës në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 ka fituar me shumë se 2000 vota.

Mos emërimi i anëtarit nga radhët e PDAK në KKZ të Prishtinës reflekton në mos pjesëmarrjen e komisionerëve të PDAK në vendotime, përbërja e KKZ-së reflekton në përbërje të KVV, dhe se komuniteti ashkalinj në Prishtinë janë me shumë se 3000 banorë, gjë që është me se e domosdoshme që të kemi një përfaqësues në KKZ të Prishtinës, andaj kërkojmë nga PZAP që të obligoi KQZ-në, për emërimin e kandidatit tonë në KKZ-në e Prishtinës, theksohet në ankesë.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.08/L – 228, LZP nenin 67.1 nënparagrafi 1 dhe 2 shprehimisht thuhet se të drejtën për të nominuar anëtarë të KKZ-ve, kanë subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor. Po ashtu në përgjigje theksohet se konform nenit të lartpërmendur të LZP-së, koalicioni politik PDAK-LPB, nuk ka kaluar pragun zgjedhor dhe nuk ka fituar ulëse në zgjedhjet paraprake për Kuvendin e Kosovës 2021, prandaj nuk ka të drejtë ligjore për të nominuar anëtarë të KKZ-së, për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 9 Shkurt 2025. Përgjigjes në ankese KQZ, i ka bashkangjitur kopjen e subjekteve politike të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor dhe kanë fituar ulëse për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në vitin 2021.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së parashtuar nga ankuesi, gjeti se:

- *Ankesa është e pabazuar*

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 69 paragraf 7 të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e parashtimit dhe vendosjes së ankesave.

Pretendimet ankimore të parashtuesit të ankesës se me rastin e marrjes se vendimit nga KQZ, lidhur me mos emërimin e anëtarit nga radhët e koalicionit PDAK dhe LpB si anëtar

i KKZ-së në Komunën e Prishtinës, nuk qëndrojnë pasi që dispozitat ligjore të nenit 67 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashohin se të drejtë për të nominuar anëtarë të KKZ-ve, kanë subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor, si dhe nëse kanë fituar ulëse në zgjedhjet paraprake për Kuvendin e Kosovës.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr.01/1641-2024, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 67, paragraf 1, nën paragrafi 1.2 të LZP-së, sepse koalicioni PDAK- LpB, nuk ka kaluar pragun zgjedhor dhe nuk ka fituar ulëse në zgjedhjet paraprake për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura në vitin 2021, dhe se e njëjta nuk ka të drejtë ligjore për të nominuar anëtarë të KKZ-ve për Zgjedhjet të cilat do të mbahen me datë 9 Shkurt 2025.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**A.nr.10/2024, datë 20.09.2024**

**Kryesues i Panelit**  
**Arsim Hamzaj**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.